



P.nr.06/2017

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm,** përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, në lëndën penale kundër të akuzuarit nga fshati , Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP II. Nr.77/2017, të datës 20.01.2017, të cilën e ka përfaqësuar prokurorja e shtetit K. F., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 31.07.2017, ndërsa më datë 01.08.2017 mori dhe shpalli këtë :

### AKT GJYKIM

I I akuzuari nga babai dhe nëna , e lindur , i lindur më 23.02.1991, në Gjilan, tani me vendbanim në Komuna e Novobërdës, Sërbë, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer , i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij ,

### Është fajtor

Më datë 11.01.2017, rreth orës 07:30 min. në Komuna e Novobërdës, deri sa i akuzuari , ka qenë në lëvizje me automjetin " " me tabela të regj. nga pakujdesi aka ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre , në atë mënyrë që nga mospërshtatja e shpejtësisë së automjetit të tij dhe kushteve dhe gjendjes së rrugës (duke qenë rruga e mbuluar me borë- ngritca) në mënyrë që automjeti i tij ta ndali para çdo pengese që i paraqitet në rrugë, e në kundërshtim me dispozitën e nenit 54.1 të Ligjit për Regullat e Trafikut Rrugor nr.05/L-088. me të arritur në dalje të pikërisht tek shtëpia e , me pjesën e e përparme të anës së djethhtë e godet mbrapa këmbësorin tani të dëmtuarin i cili ishte duke ecur përskaaj anës së djethhtë shiquar në drejtim të Gjilanit, me që raste si pasoj e goditjes i dëmtuari përplaset për tokë dhe pëson lëndime të lehta trupore për cka detyrohet të kërkoj ndihëm mjeksore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, sipas raportit nr. të dt.

- me këtë ka kryer veprë penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 52, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarin:

## E G J Y K O N

Me dënime me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, e i cili dënim nuk ka për tu ekzekutuar në qoftë se i akuzuari në afat prej 1 (nji) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjygjësor tëi paguaj shumën prej 20€, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plothuqishmërisë së këtij aktgjykim nën kanosje përmbarimi të dhunshëm.

I dëmtuari ..... për realizimin e kërkesave pasurore juridike udhëzohen në kontestin civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr 77/2017 të datës 20.01.2017 kundër tani të akuzuarit ..... nga ..... për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 31.07.2017, Prokurorja e Shtetit, K. .... F. .... deklaroi: në tersi mbetem pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim dhe i propozoj gjykatës të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë me dënim meritor sipas ligjit gjithni duke marrë për bazë të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.

I akuari D. .... në seancën fillestare ka deklaruar: e pranoi fajsinë për të gjitha pikat e aktakuzës, pendohem për krerje e kësaj veprë penale, se këtë pranim të fajsisë e bëj në mënyrë vullnetare, andaj e dhe i pranoj të gjitha pasojat dhe benefitet e këtij pranimi dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoi një dënim sa ma të butë.

Me qenë se i akuzuari ..... në shqyrtimin fillestar të kësaj çështje penale e ka pranuar fajsinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e cila aktakuzë ia venë në barrë veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 379 par 6 lidhur me paragraf 1 të KPRK-ës, e me këtë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është kontestuese, sepse përpos pranimi të fajsisë nga ana e vet të akuzuarit, një pranim i tillë i fajsisë ka mbështetje në provat e grumbulluara që gjenden në shkresat e lëndës se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajsinë, se e ka kuptuar natyrën dhe pranimin e fajit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të

qartë ligjore ,andaj gjykata vazhdoi procesin ndaj të njëjtit me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtimin gjyqësor duke vepruar kështu në pajtim me dispozitën e nenit 248 par.4.të KPKsë,edhe pa fjaë përfundimtare të palëve.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësin së dënimit, për të akuzuarin gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë rëdsi që dënimi të jetë më butë apo më i rëndë, ashtu si që e parashifet me dispozitën e neneve 73 dhe 75 të KPRK-ës. Kështu si rretanë lehtësuesi për të akuzuarin gjykata pati parasysh pranimin e fajsisë, pendimin për kryerjen e kësaj vepre penale, si dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesëshëm gjat vozitjes,kushtet klimatike në momentin e kryerjes së kësaj vepre penale sepse rruga ka qenë e mbulluar me akull dhe e rëshitshme, gjendjen familjare se është i pamartuar, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata pat parasysh shkallën e përgjegjesis penale si dhe rrezikshmërin shoqrore sikur edhe pasojat e veprës penale, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim me kusht si në dispozitiv me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj në mënyrë që i akuzuari në të ardhmen mos të kryeë vepër tjetër penale por që me një dënim të tillë të ndikohet edhe tek të tjerët për të mos kryer vepra tjera penale .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 453 parag 1 lidhur me nenin 450 para.2 e 6 të KPPK-ës.

Venimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë në bazë të dispozitës së nenit 463 par. 1 të KPPK-ës

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -DEGA NOVOBERDE**

Departamenti i përgjithshëm

Më 01.08.2017

**Zyrtarja ligjore**  
**Hikmete Veliu -Pajaziti**



Gjyqtari

**Asan Sadiku**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykates së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj gjykate.